REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I SHRB SOCIO-KULTURORE

Nr.254/1 Prot

Pustec, më 19.02.2026

PROJEKT- VENDIM
Nr. 1 datë 19.02.2026

PËRCAKTIMI I NJË FONDI PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR GRUPIN E VALLËTARËVE TË BASHKISË PUSTEC ME HONORAR FIKS MUJOR

Sektori i shërbimeve socio-kulturore mbështetur në neni 8, pika 2, neni 9, pika 1,1.1, shkronja "a" dhe "b" , neni 24, pika 1, neni 55, pika 2 dhe 6, ligji nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligji nr.10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", dhe VKM Nr. 1173, date 06.11.2009 "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin e Ngjarjeve Kulturore, Artistike dhe Sociale nga Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Institucionet e tjera Publike, të Pavarura", VKB nr.100 datë 24.12.2025 " Për miratimin e Planit të Buxhetit për vitin 2026" I propozojmë Këshillit Bashkiak

PROPOZON

- Të miratojë shpërblimin për 12 (dymbëdhjetë) anëtarë të grupit artistik (valltarë dhe organizatorë), për një periudhë njëvjeçare. Pagesat do të bëhen në formën e honorarit fiks mujor, sipas ndarjes që do të përcaktohet nga sektori i kulturës dhe financës së Bashkisë.
- Masa e shpërblimit të jetë 6,600 lekë në muaj për person, për vitin 2026.
- Fondi total për shpërblimin e vallëtarëve do të përballohet nga buxheti i bashkisë, në zërin përkatës për kulturë dhe aktivitete artistike.
- Ngarkohet Sektori i Financës dhe sektorët përgjegjëse për kulturën për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe zbatohet për periudhën njëvjeçare sipas përcaktimeve të tij.

SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIO-KULTURORE
Sp.turizmit, kulturës, rinisë dhe sporteve

F. Deleguar
KLAUDIA KOHOPULLI

KRYETAR I BASHKISË
Pali KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PUSTEC

Adresa: Pustec, Korçë e-mail:bashkia.pustec@gmail.com Tel. 086792012